



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
REKTORI

Nr. 2031/11 Prot.

Tiranë, më 26.10.2021

UDHËZIM

Nr. 3 datë 26.10.2021

PËR

**“APLIKIMIN DHE REGJISTRIMIN E KANDIDATËVE NË KUOTAT E PAPLOTËSUARA PËR PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË DHE TË INTEGRUAR TË CIKLIT TË DYTË, RAUNDI IV, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË, VITI AKADEMIK 2021-2022”**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”, Udhëzimit të MASR nr. 10, datë 15.05.2019 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në Institucionet e Arsimit të Lartë” i ndryshuar, lidhur me procesin e aplikimit dhe regjistrimit në kuadër të plotësimit të kuotave të mbetura bosh në programet e studimit të ciklit të parë dhe të integruar të ciklit të dytë, Raundi IV,

UDHËZOJ:

1. Kandidatët që kanë aplikuar në raundin e III, në programin përkatës të studimit në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, të cilët nuk kanë qenë fitues dhe nuk janë të regjistruar në një program tjetër studimi, të paraqesin pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore (fakultetit) përkatës kërkesën me shkrim për regjistrim në atë program studimi (sipas modelit të shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij Udhëzimi), në datat **28-29 tetor 2021**, nga ora **8:00** deri në **14:00**.
2. Njësitë kryesore (fakultetet) brenda datës **29 tetor**, ora **16:00** përcjellin në Rektorat listat e kandidatëve sipas renditjes. Publikimi i listave bëhet më datë **29.10.2021** në mjediset e universitetit dhe në faqen zyrtare të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe njësive kryesore.
3. Më datat **30-31 tetor 2021**, bëhet regjistrimi i kandidatëve sipas renditjes së shpallur në pikën 2, pranë njësive kryesore (fakulteteve) në përputhje me kuotat e mbetura bosh, si më poshtë:

**Data 30 tetor 2021**

Faza I – ora 9.00-11.00

Faza II – ora 11.00-13.00

Faza III- ora 13.00-15.00

**Data 31 tetor 2021**

Faza I – ora 9.00-11.00

Faza II – ora 11.00-13.00

Faza III- ora 13.00-15.00

4. Për zbatimin e këtij Udhëzimi ngarkohen njësitë kryesore të UMT-së dhe sekretaritë mësimore.





**Shtojca nr. 1**

**FORMULAR KËRKESE  
RAUNDI IV**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, ID e maturës \_\_\_\_\_, aplikant i Raundit të III në programin e studimit \_\_\_\_\_, paraqes kërkesën time për të vijuar konkurrimin në këtë program.

- Deklaroj se nuk jam regjistruar në asnjë program tjetër studimi.
- Jam informuar nëpërmjet faqes zyrtare të njësisë kryesore (fakultetit) dhe universitetit, për Udhëzimin e Rektorit të UMT-së nr. 3, datë 26.10.2021 "*Për aplikimin dhe regjistrimin e kandidatëve në kuotat e paplotësuara...*", lidhur me publikimin e renditjes dhe fazat e regjistrimit të kandidatëve.

\_\_\_\_\_  
Emër

\_\_\_\_\_  
Atësi

\_\_\_\_\_  
Mbiemër

Nr. telefoni: